



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave
Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance

**Raporti gjashtë-mujor (Janar-Qershor) 2017 i zbatimit të
Strategjisë për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike
(SRMFP) të Kosovës 2016-2020**

Prishtinë
2017

Përmbajtja

Shkurtesat	3
Hyrje.....	4
<i>Progresi i përgjithshëm në zbatimin e fushave prioritare të Strategjisë</i>	4
1.1 Shtylla 1.- Disiplina fiskale.....	6
Prioriteti 1: Saktësia e parashikimit të indikatorëve makroekonomik dhe të hyrave.....	6
Prioriteti 2: Kontrollat efektive të zotimeve.....	7
Prioriteti 3: Mbledhja e qëndrueshme e të hyrave.....	8
1.2 Shtylla 2.- Efikasiteti alokues	9
Prioriteti 4: Zhvillimi i kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH).....	9
Prioriteti 5: Besueshmëria dhe kontrolli i ekzekutimit të buxhetit vjetor	9
Prioriteti 6: Cilësia e informatave të buxhetit kapital	10
1.3 Shtylla 3.- Efikasiteti operacional	10
Prioriteti 7: Prokurimi Publik.....	10
Prioriteti 8: Fuqizimi i auditimit të brendshëm	11
Prioriteti 9: Fuqizimi i auditimit të jashtëm	11
1.4 Shtylla 4.- Çështjet e ndërlidhura të MFP.....	12
Prioriteti 10: Përmirësimi i sistemeve të TI	12
Prioriteti 11: Transparenca për buxhetin.....	13
Prioriteti 12: Ngritja e qëndrueshme e kapaciteteve në MFP.....	13
ANEKSI 1: SHPJEGIM I DETAJUAR MBI ZBATIMIN E SECILIT AKTIVITET	14

Shkurtesat

AB - Auditimi i Brendshëm
ATK - Administrata Tatimore e Kosovës
BB - Banka Botërore
BDMS - (Budget Development and Management System) - Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit
BE - Bashkimi Evropian
BQK – Banka Qendrore e Kosovës
DIEKP – Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave
DOJQ – Departamenti për Organizatat Jo-Qeveritare, MAP
FMN - Fondi Monetar Ndërkombëtare
GDPS - Grupi Drejtues për Planifikim Strategjik
IPSAS - (International Public Sector Accounting Standards) - Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
ISSAI – (International Standards of Supreme Audit Institutions) Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
KASH - Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KBFP - Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike
KEDS - Kosovo Electricity Distribution and Supply Company J.S.C
KRPP - Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
LMFPP - Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
MF - Ministria e Financave
MFP - Menaxhimi i Financave Publike
NjQH – Njësia Qendrore Harmonizuese
OB - Organizatat Buxhetore
PIP - Programi i Investimeve Publike
SFQ (GFS)–FMNS – Statistikat Financiare Qeveritare
SIGMA - (Support for Improvement in Governance and Management) - Përkrahje për Përmirësim në Qeverisje dhe Menaxhment
SIMFK - Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës
SKZH - Strategjinë Kombëtare për Zhvillim
SRMFP - Strategjia për Reformën e MFP
TI – Teknologjia e Informacionit
TVSH – Tatimi në Vlerën e Shtuar
VNB – Vlerësimi i Ndikimit Buxhetor
ZKA - Zyra Kombëtare e Auditorit

Hyrje

Ky raport përmbledh dhe paraqet arritjet e objektivave dhe progresin në zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë së Reformës së Menaxhimit të Financave Publike (SRMFP) gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2017. Hartimi i raportit monitorues gjashtëmuajor ka për qëllim shqyrtimin e progresit të arritur në zbatimin e strategjisë. Për më shumë ky raport ka karakter informues me qëllim të identifikimit të problemeve në zbatim të strategjisë si dhe adresimin me kohë të tyre. Sipas mandatit të dhënë me Vendimin e Ministrit, Nr. 43/2016, Grupi Koordinues obligohet të përgatisë raporte të rregullta vjetore dhe gjashtëmuajore. Pas finalizimit të raportit të parë vjetor për vitin 2016, ky është raporti i parë gjashtëmuajor i cili paraqet progresin e arritur në zbatimin e aktiviteteve të planifikuara gjatë vitit 2017.

Qasja e adoptuar në përgatitjen e raportit gjashtëmuajor është bazuar në udhëzimet e OECD/SIGMA të përmbledhura në Udhëzuesin për raportim, dhe modelin e raportimit 6 mujor të dakorduar në takimin e Grupit Koordinues për MFP në Korrik 2017. Metodologjia e përdorur ka qenë një kombinim i takimeve dhe konsultimeve në mes të DIEKP (MF) dhe bartësve kryesor të secilit prioritet. Fillimisht, bazuar në Udhëzuesin e aprovuar, është plotësuar tabela raportuese me kontribute nga bartësit kryesor dhe pastaj është përpiluar Raporti narrativ gjashtëmuajor.

Raporti i parë gjashtë muajorë i zbatimit të Strategjisë për Reformat e MFP evidenton progres të arritur në shumicën e aktiviteteve të parapara. Bazuar në raportet e pranuar nga strukturat përgjegjëse, gjatë periudhës 6 mujore nga gjashtëdhjetë e gjashtë (66) aktivitetet e planifikuara raportohet se në dyzet e gjashtë (46) prej tyre janë zbatuar apo ka filluar zbatimi pa vonesa. Në pesëmbëdhjetë (15) aktivitete ka filluar zbatimi por evidentohen vonesa. Ndërsa pesë (5) aktivitete planifikohen të zbatohen duke filluar nga viti 2018.

Strategjia e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike (SRMFP), është ndërtuar mbi 4 shtylla dhe 12 prioritete që përfshijnë të gjithat fushat e reformës së Menaxhimit të Financave Publike.

Progresi i përgjithshëm në zbatimin e fushave prioritare të Strategjisë

Në shtyllën e parë të Strategjisë **Disiplina Fiskale**, gjithsej janë të planifikuara të zbatohen 27 aktivitetet të ndara në tri prioritete kryesore: 1. Saktësia e parashikimit të indikatorëve makroekonomik dhe të hyrave, 2. Kontrollat efektive të zotimeve, 3. Mbledhja e Qëndrueshme e të hyrave. Bazuar në raportet e strukturave përgjegjëse, gjatë periudhës 6 mujore, nga 27 aktivitetet e planifikuara raportohet se 18 prej tyre janë të përfunduara apo ka filluar të zhvillohen aktivitetet dhe nuk ka vonesë. Në 7 prej tyre ka vonesë apo nuk është raportuar të ketë progres. Ndërsa 2 prej tyre planifikohen të zbatohen në pjesën e dytë të vitit apo janë aktivitete për vitet në vijim.

Si rezultat, në indikatorin e parë dhe më të rëndësishëm, përmes aktiviteteve të ndërmarra, mund të raportojmë trend të njëjtë të shmangies mesatare të parashikimit të hyrave tatimore në krahasim me raportimet kontabël të vitit 2016. Ky indikator është 3.815%, në periudhën Janar-Qershor të vitit 2017. Kjo dëshmon për progres në përmirësim të gjendjes në krahasim me nivelin bazë. Gjithashtu gjatë kësaj periudhë është arritur progres në zbatimin e aktiviteteve drejt realizimit të prioritetit Nr.2. gjegjësisht objektivit për Zvogëlimin e vonesave të pagesave duke e rritur pajtueshmërinë me kontrollat e aplikueshme të zotimeve.

Përgjatë gjashtë muajorit të parë të vitit 2017, zhvillimet kryesore për të arritur objektivat në fushën e forcimit të kontrollin të brendshëm kanë qenë si në vijim:

- Zvogëlimi i vonesave të pagesave duke e rritur pajtueshmërinë me kontrollet e aplikueshme të zotimeve
- Fuqizimi i funksionit të auditimit të brendshëm si shërbim me vlerë të shtuar ndaj menaxhimit llogaridhënës

Në shtyllën e dytë **Efikasiteti Alokues**, gjithsej janë të planifikuara të zbaton 12 aktivitete të ndara në tri prioritete kryesore: 4. Zhvillimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, 5. Besueshmëria dhe kontrolli i ekzekutimit të buxhetit vjetor, 6. Cilësia e informatave në buxhetin kapital. Bazuar në raportet e strukturave përgjegjëse, gjatë periudhës 6 mujore, raportohet se në dhjetë (10) prej tyre janë zbatuar apo ka filluar zbatimi pa vonesa. Në dy (2) aktivitete nuk ka të paraparë asgjë në vitin 2017.

Progresi është arritur në fuqizimin e besueshmërisë së buxhetit vjetor përmes përmirësimit të planifikimit buxhetor dhe besueshmërisë së tij duke siguruar që hartimi i buxhetit është në përputhje me kornizën makro-fiskale si dhe objektivat strategjike të Qeverisë. Në këtë drejtim është shqyrtuar Deklarata e Prioriteteve dhe KASH (2018-2020) nga Grupi Drejtues për Planifikim Strategjik.

Në bazë të raportimeve ende mbetet sfida, përqindja e shmangies mesatare të kufirit të shpenzimeve të planifikuara me KASH dhe kufirit vjetor buxhetor për OB në vitin 2017.

Numri i zyrtarëve të trajnuar për vlerësimin e ndikimit buxhetor-VNB gjatë kësaj periudhe të vitit 2017 ishte 50, dhe është në trend pozitiv drejt arritjes së synimit vjetor. Ndërsa sa i përket aktiviteteve në lidhje me zbatimin e Prioritetit 6. Cilësia e Informatave në Buxhetin kapital, Dep. i Buxhetit (MF) ka filluar hapat rreth hartimit të rregullores e cila pritet të finalizohet deri në fund të vitit 2017, ndërsa deri në Maj të viti 2017 ky Departament ka trajnuar 40 zyrtare për sistemin e PIP.

Në shtyllën e tretë të strategjisë **Efikasiteti funksional**, gjithsej janë të planifikuara të zbatohen 15 aktivitete të ndara në tri prioritete kryesore: 7. Prokurimi Publik, 8. Fuqizimi i Auditimit të Brendshëm, 9. Fuqizimi i Auditimit të Jashtëm. Bazuar në raportet e strukturave përgjegjëse, gjatë periudhës 6 mujore nga gjithsej 15 aktivitete, raportohet se në njëmbëdhjetë (11) prej tyre janë zbatuar apo ka filluar zbatimi pa vonesë. Në dy (3) aktivitete raportohet të mos këtë zhvillime, ndërsa në një (1) aktivitet planifikohet të fillohet me zbatim më vonë (2018).

Në këtë kontekst, mund të thuhet që aktivitetet që kanë të bëjnë me fushën e prokurimit, janë duke u realizuar konform planit të aktiviteteve. KRPP gjatë kësaj periudhe ka arritur avancimin e sistemit të monitorimit të zbatimit dhe atë jo vetëm në monitorimin e pajtueshmërisë por edhe të efikasitetit gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit publik. Për më shumë, aplikimi i sistemit elektronik nga të gjitha autoritetet kontraktuese nga 1 janari i vitit 2017, është një element shtytës për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit gjatë zbatimit të ligjit të prokurimit. Po ashtu është shënuar progres i kënaqshëm në zbatimin e aktiviteteve në fushën e auditimit të brendshëm, ku si rezultat është raportuar për përmirësim të përqindjes së auditorëve të brendshëm të certifikuar (83% Qershor 2017, krahasuar me vlerën bazë prej 50%) dhe në të njëjtën kohë është shënuar progres në implementim të rekomandimeve të auditorit të brendshëm në 54.6% (viti 2016) nga 51% të vlerës bazë. Gjithashtu është arritur progres në fuqizimin e auditimit të jashtëm. Gjatë kësaj periudhe është raportuar për azhurnim të rregullt të udhëzuesit dhe metodologjisë së ZKA-së për auditimin e rregullsisë dhe performancës në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit. Po ashtu kanë vazhduar bashkëpunimet me dy komisionet parlamentare: Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe Komisioni për Buxhet për të diskutuar në lidhje me përmbledhjet e raporteve të auditimit të ZKA për Komisionet parlamentare, më konkretisht përgatitja e materialeve për trajtimet e Raporteve të auditimit.

Në shtyllën e katërt të strategjisë **Cështjet e ndërlidhura me MFP**, gjithsej janë planifikuar të zbatohen 12 aktivitete të ndara në tri prioritete të ndryshme: 10. Përmirësimi i Sistemeve të TIsë, 11. Transparenca për Buxhetin dhe 12. Ngritja e Qëndrueshmërisë së Kapaciteteve në MFP. Bazuar në raportet e strukturave përgjegjëse, gjatë periudhës 6 mujore, nga dymbëdhjetë (12) aktivitetet e planifikuara raportohet se në gjashtë (6) prej tyre janë zbatuar apo ka filluar zbatim sipas planit. Gjashtë (6) prej tyre pritet të fillohet me zbatim por me vonesë krahasuar me planin. Në përgjithësi mund të raportohet progres në këtë shtyllë, por gjithashtu priten aktivitete të shtuara në pjesën e mbetur të vitit.

Thesari gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore ka zhvilluar një mori aktivitete në funksion të përmirësimit të sistemit të teknologjisë informative dhe proceseve që ndërlidhen me procesin buxhetor. Gjatë kësaj periudhe SIMFK ka komunikuar/ndërlidhur në mënyre elektronike me këto sisteme të treta si: Sistemi i Pagesave Ndër-Bankare në BQK, BDMS, PIP, ZKA, ATK, Dogane, DOJQ, KEDS. Janë gjeneruar raporte elektronike me të gjitha sistemet e treta me të cilat Thesari ka marrëveshje për shkëmbimin e të dhënave. Gjithashtu progres është shënuar edhe në transparencën buxhetore, duke bërë publikimin e të dhënave mujore serike. Po ashtu është raportuar për avancim në raportim sipas standardeve SFQ (GFS)–FMNS, që përfshinë harmonizimin e planit kontabël aktual me standardet e GFS. Në kuadër të fuqizimit të kapaciteteve në fushën e MFP është raportuar për hartim të Termave të Referencës për studimin e fizibilitetit. Përfundimi i Studimit është parakusht për zbatimin e dy aktiviteteve vijuese. Më poshtë është dhënë një vlerësim më i detajuar i progresit të bërë në secilën prej fushave prioritare

1.1 Shtylla 1.- Disiplina fiskale

Prioriteti 1: Saktësia e parashikimit të indikatorëve makroekonomik dhe të hyrave;

Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2017, mund të raportojmë se trendi i realizimit të hyrave buxhetore ka mbetur i njëjtte me vitin 2016, parashikimi i besueshëm dhe i saktë i të hyrave si kornizë përcaktuese për mundësitë financiare për financimin e politikave publike dhe rreziqet e asocuara. Megjithatë ajo çfarë mund të thuhet është se gjatë këtij gjashtëmujori (Janar–Qershor 2017), nga pesë aktivitete të planifikuara për arritjen e këtij prioriteti në dy aktiviteti kemi të raportuar progres, në dy prej tyre (1.4-1.5) nuk është raportuar për progres gjatë kësaj periudhe raportuese, dhe një aktivitet planifikohet të zbatohet në vitin 2018 (1.2)¹.

Ministria e Financave (MF), ka punuar në avancimin e modelit për parashikimin e indikatorëve makroekonomik, standardizimin metodik por edhe ngritjen/zhvillimin e resurseve njerëzore të angazhuara në këto role përmes trajnimeve të organizuara.

Në indikatorin e parë, dhe më të rëndësishëm, përmes aktiviteteve të ndërmarra, mund të raportojmë trend të njëjtë të shmangies mesatare të parashikimit të të hyrave tatimore në krahasim me raportimet kontabël të vitit 2016. Ky indikator është 3.815%, në periudhën Janar Qershor të vitit 2017, dhe dëshmon për përmirësim të gjendjes në krahasim me nivelin bazë. Në pjesën e të hyrave të njëhershme, sipas raportit gjashtë mujor të departamentit të Thesarit, në të hyrat tatimore vendore gjatë periudhës raportuese janë përfshirë edhe të hyrat e njëhershme nga arkëtimi i borxhit tatimor në shumën prej 2.1 milionë euro. Për shkak që ligji

¹ Shpjegimet detaje për progresin në secilin aktivitet janë dhënë në Aneksin 1

për faljen e borxheve është në fuqi deri më 31.08.2017, pritjet janë që gjatë muajve Korrik dhe Gusht të hyrat në këtë kategori të kenë rritje.

Nëse e zbrisim vlerën prej 2.1 mil. Euro që janë inkasuar nga të hyrat e njëhershme atëherë na del se shmangia mesatare e parashikimit të të hyrave tatimore në krahasim me ekzistueset është 4.12%, ndërsa tek të hyrat e njëhershme realizimi del të jetë 42%.

Objektivi	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	2016	Qëllim i 2020	Raportimi 2017
Një parashikimi i kujdesshëm dhe real i të hyrave tatimore të buxhetit dhe të hyrave të njëhershme.	1. Shmangia mesatare e parashikimit të të hyrave tatimore në krahasim me ekzistueset.	(-7.7%)	3.82%	0 – 3%	3.815%
	2. Shmangia mesatare e parashikimit të të hyrave që ndodhin në buxhet vetëm një herë në krahasim me ekzistueset.	7.6%		4%	Raportimi ne baze vjetore

Prioriteti 2: Kontrollat efektive të zotimeve

Aftësia për të shlyer në kohë (1-30 ditë) pagesat e arritura është paraparë në Prioriteti 2 të reformës në shtyllën e parë. Qëllimi i këtij prioriteti, kontrollat efektive të zotimeve, synohet të arrihet duke menaxhuar më mirë vonesat e pagesave përmes kontrolleve financiare në zotime.

Gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2017, është raportuar të jetë shënuar progres i pjesshëm në zbatimin e aktiviteteve drejt realizimit të prioritetit Nr.2. gjegjësisht objektivit për Zvogëlimin e vonesave të pagesave duke e rritur pajtueshmërinë me kontrollat e aplikueshme të zotimeve.

Zhvillimet kryesore për të arritur Objektivat: në fushën e forcimit të kontrollit të brendshëm përgjatë gjashtë muajorit të vitit 2017 kanë qenë si në vijim:

- Zvogëlimi i vonesave të pagesave duke e rritur pajtueshmërinë me kontrollat e aplikueshme të zotimeve
- Fuqizimi i funksionit të auditimit të brendshëm si shërbim me vlerë të shtuar ndaj menaxhimit llogaridhënës

Ministria e Financave ka lansuar pyetësin e vetë-vlerësimit të kontrollit të brendshëm. Pyetësi, përkatësisht monitorimi i përgjigjeve të dhëna nga OB është pjesë e raportit vjetor të NjQH. Ky veprim, ndonëse në fazat fillestare, bëhet përmes monitorimit të një numri të caktuar të OB-ve. Pyetësi vet-vlerësues është pjesë e auditimit vjetor të ZKA-së, përkatësisht ZKA do të shqyrtojë përgjigjet në fusha të caktuara të pyetësit të vetë-vlerësimit të kontrollit të brendshëm.

Veprimi kryesor do të jetë që të synojë monitorimin gjithnjë e në rritje të organizatave buxhetore që janë shpenzues të mëdhenj dhe të kërkojë prej tyre plotësimin e pyetësit të vetë-vlerësimit të kontrollit të brendshëm. Në të njëjtën kohë NjQH do të koordinojë ngushtë me ZKA-në për të ndjekur pyetësin e vetë-vlerësimit të kontrollit të brendshëm. Ky tregues gjithashtu lidhet me veprimet dhe rezultatet e aktiviteteve që mbulojnë forcimin e funksionit të

auditimit të brendshëm të matura me Certifikimin e Auditorëve të Brendshëm, zhvillimin e mëtejshëm të stafit të NJQH dhe veprimet që kanë të bëjnë me librin e proceseve.

Nga gjithsej dhjetë (10) aktivitete të planifikuara për zbatim të këtij prioriteti, në pesë (5) prej tyre është raportuar për progres në zbatim gjatë kësaj periudhe, në katër (4) prej tyre ka aktivitet por me vonesë krahasuar me planin dhe në një (1) prej tyre me plan është paraparë aktivitet në vitin 2018².

Objektivi	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Qëllimi 2018	Qëllimi 2020	Raportimi 2017
Zvogëlimi i vonesave të pagesave duke e rritur pajtueshmërinë me kontrollet e aplikueshme të zotimeve.	Borxhet e pakryera të pagesave deri në fund të vitit fiskal si % e totalit të shpenzimeve..	3.4%	2%	1%	Raportimi ne fund të vitit fiskal

Prioriteti 3: Mbledhja e qëndrueshme e të hyrave

Mbledhja e qëndrueshme e të hyrave është një nga prioritetet kryesore në drejtim të integritetit të përgjithshëm të menaxhimit të financave publike. Janë gjithsej 12 aktivitete të planifikuara për realizim të këtij prioriteti me përgjegjësi të ndara në mes të ATK-së dhe Doganës së Kosovës. Nga të gjitha aktivitetet e planifikuara në njëmbëdhjetë (11) prej tyre është raportuar progres sipas planit, kurse në një (1) nuk raportohet të ketë pasur progres gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore për shkak të mungesës së mjeteve financiare (3.2).

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2017, me aktivitete të vazhdueshme është ngritur performanca e agjencive tatim-mbledhëse dhe është rritur qëndrueshmëria e mbledhjes së të hyrave përmes zgjerimit të bazës tatimore, masave kundër evazionit fiskal dhe kontrabandës. Numri i bizneseve të regjistruara për TVSH ka tejkaluar numrin prej 20,000 bizneseve. Gjithashtu është arritur përqindja e mbledhjes së borxheve prej 16.82% në gjashtë mujorin e parë 2017.

Objektivi	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Qëllimi 2018	Qëllimi 2020	Raportim i 2017
Zgjerimi i bazës tatimore përmes luftimit të evazionit fiskal dhe kontrabandimit të mallrave.	Numri i bizneseve të regjistruara për TVSH	16,583	21,750	35,000	20,363
	Numri i tatimpaguesve që i deklarojnë të ardhurat në mënyrë vullnetare.	62,886	73,117	100,000	56,610
	Shkalla e mbledhjes së borxheve.	16%	18%	19%	16.82%

² Shpjegimet detaje për progresin në secilin aktivitet janë dhënë në Aneksin 1

1.2 Shtylla 2.- Efikasiteti alokues

Prioriteti 4: Zhvillimi i kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH)

Ndërlidhja në mes të strategjive kombëtare dhe planifikimit buxhetor afatmesëm dhe vjetor është arritja më sfiduese edhe në terma të politik bërjes por edhe të kapaciteteve teknike. Ndër vite ne kemi parë një trend zhvillimi pozitiv në proceset dhe përmbajtjen e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve. Nga gjithsej pesë (5) aktivitete të planifikuara, raportohet progres në zbatimin sipas planit.

Vlerësimet deri në qershor 2017 raportojnë për një ndërlidhje më të madhe të strategjive kombëtare proceseve buxhetore përmes avancimit të rolit të KASH si një instrument i planifikimit dhe ndarjes afatmesëm të buxhetit. Qasja sektoriale, komunikimi dhe këshillimi i profesionalizuar nga MF ka ndikuar në fuqizimin e integritet të KASH si dokument bazë për përpilimin e buxhetit vjetor dhe parashikimet për dy vitet e ardhshëm.

Përqindja e shmangies mesatare të indikatorit të parë që ka të bëjë me shmangien ndërmjet kufirit të KASH-it dhe kufirit vjetor buxhetor për OB-të në vitin 2017 ka shënuar tejkalim të planit duke arritur në 22.03%. E theksojmë që, kjo % e shmangies ka ndodh sepse është rritur kufiri i shpenzimeve në mes të KASH-it dhe Buxhetit të aprovuar në Kuvend për vitin 2017 në shumë prej 180 milion €. Kjo shumë është shpërndare nëpër OB.

Sa i përket indikatorit të dytë në këtë periudhë janar-qershor 2017, numri i zyrtarëve të trajnuar për vlerësimin e ndikimit buxhetor (VNB), me trajnime dhe këshillime të personalizuara, ka qenë rreth 50.

Objektivi	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	2017	Qëllimi 2020	Raportimi janar-qershor 2017
Avancimi i mëtejshëm i rolit të KASH si dokument ndërlidhës ndërmjet Strategjive Kombëtare dhe planifikimit të buxhetit për tre vitet e ardhshme..	1. Përqindja e shmangies mesatare ndërmjet kufirit të KASH dhe kufirit vjetor buxhetor për OB-të.	7.15 %	6.5 %	3.5%	22.03%
	2. Numri i zyrtarëve të trajnuar për vlerësimin e ndikimit buxhetor-VNB.	80	90	120	50

Prioriteti 5: Besueshmëria dhe kontrolli i ekzekutimit të buxhetit vjetor

Fuqizimi i besueshmërisë së buxhetit vjetor përmes përmirësimit të planifikimit buxhetor përfshirë planifikimin në nivel të programeve dhe përputhjes me kornizën makro-fiskale si dhe objektivat strategjike të Qeverisë është një ndër prioritetet e SRMFP.

Gjatë periudhës raportuese nga gjithsej tri (3) aktivitete në kuadër të këtij prioriteti, në dy (2) prej tyre është raportuar progres ndërsa një (1) aktivitet (5.3) parashihet të zbatohet në vitin 2018.

Sa i përket shmangies mesatare (%) te ekzekutimit të përgjithshëm të buxhetit krahasuar me buxhetin e aprovuar në fillim të vitit sipas OB-ve të nivelit qendror, në këtë periudhë të raportimit nuk mundemi të raportojmë, pasi që për matjen e këtij indikatorit duhet të merret për bazë buxheti i aprovuar në fillim të vitit dhe buxheti në fund të vitit, dhe ne ende jemi në proces të realizimit të buxhetit deri me 31 dhjetor 2017, kur behet edhe përmbyllja për vitin fiskal 2017. Po ashtu edhe për indikatorin e dytë nuk mundemi të raportojmë në këtë periudhë gjashtëmujore, pasi që për llogaritjen e këtij indikatorit duhet të merret për bazë numri i transfereve të përgjithshme gjatë tërë vitit fiskal për vitin 2017.

Prioriteti 6: Cilësia e informatave të buxhetit kapital

Ndërlidhja sistematike e projekteve kapitale me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (SKZH) dhe me politikat sektoriale, dhe cilësia e analizës teknike të projekteve është një nga objektivat e SRMFP. Është vazhduar me rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të menaxhimit të planifikimit dhe monitorimit të investimeve publike nga OB-të në sistemin e PIP. Në këtë fazë nuk mund të bëhet raportimi në bazë të indikatorit për shkak që indikatorit kalkulohet në bazë vjetore. Gjatë kësaj periudhe janë ndërmarrë disa hapa drejt përmirësimit të kornizës ligjore, mirëpo ende mbetet të punohet në këtë drejtim.

Gjatë periudhës raportuese nga gjithsej katër (4) aktivitetet në kuadër të këtij prioriteti, në të gjitha aktivitetet është raportuar progres në zbatim sipas afatit të planifikuar. Aktiviteti 6.4 është përfunduar në vitin 2016.

1.3 Shtylla 3.- Efikasiteti operacional

Prioriteti 7: Prokurimi Publik

Në këtë objektivi të reformës së SRMFP, veprimet e ndërmarrë kanë rezultuar me ngritje të garancive për sigurimin e përdorimit efikas dhe transparent të fondeve publike. Në gjashtë mujorin e parë të vitit 2017, mund të raportojmë se nga gjithsej pesë (5) veprimeve të planifikuara, katër (4) prej tyre janë duke u realizuar konform parashikimeve të cilat i kemi vendosur për këtë vit. Përderisa Veprimi 7.4 ka filluar së zbatuari por pritet të përfundoj në fund të vitit.

KRPP përmes këtyre veprimeve ka arritur avancimin e sistemit të monitorimit të zbatimit dhe atë jo vetëm në monitorimin e pajtueshmërisë por edhe të efikasitetit gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit publik.

Aplikimin i sistemit elektronik nga të gjitha autoritetet kontraktuese nga 1 janari i vitit 2017, është një element shtytës për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit gjatë zbatimit të ligjit të prokurimit. Prokurimi elektronik do të ketë efekte shumë-dimensionale si në rritjen e transparencës, parandalimin e keqpërdorimeve, rritjen e konkurrencës dhe shtimin e përgjegjësisë dhe besimit gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit. Prokurimi elektronik përveç tjerash në të ardhmen do të ndihmojë edhe në lehtësimin e monitorimit pasi të dhënat për performancën e autoriteteve kontraktuese mund të nxirren nga sistemi.

Edhe për këtë prioritet nuk ka mundësi të përlllogaritët zbatimi i treguesve të performancës pasi që kjo bëhet në fund të vitit.

Prioriteti 8: Fuqizimi i auditimit të brendshëm

Fuqizimit të auditimit të brendshëm në strategji i është dhënë rëndësi pasi që ndihmon menaxhmentin në arritjen e objektivave të organizatës duke dhënë këshilla të pavarura për fuqizimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm të financave publike, vlerësuar lidhjet e këtyre sistemeve në arritjen e objektivave, bërë vlerësimin e rreziqeve që shoqërohen me sistemet në arritjen e qëllimeve të qeverisë dhe ndihmon në ngritjen e standardeve të qeverisjes.

Në këtë kontekst Ministria e Financave ka vepruar në përmirësimin e infrastrukturës ligjore, nënligjore dhe në ngritjen e kapaciteteve njerëzore për një funksion më të mirë të auditimit brendshëm të matur me cilësinë e rekomandimeve të auditimit dhe zbatimin e tyre nga menaxhmenti.

Aktivitetet e ndërmarra nga Ministria e Financave në Prioritetin 8 kanë ndikuar në rritjen e përqindjes së numrit të auditorëve të brendshëm të certifikuar dhe përqindjen e rekomandimeve të zbatuara nga menaxhmenti. Nga raporti del se nga gjithsej pesë (5) aktivitetet të parapara në kuadër të këtij prioriteti, në dy (2) prej tyre është raportuar progres ndërsa në dy (2) aktivitete ka ngecje dhe një (1) parashihet të zbatohet në vitin 2018.

Objektivi	Indikator (i) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	2016	Qëllimi 2020	Raportim i 2017
Fuqizimi i funksionit të auditimit të brendshëm si shërbim me vlerë të shtuar ndaj menaxhimit llogaridhënës	<ul style="list-style-type: none">% e auditorëve të brendshëm të certifikuar.	<ul style="list-style-type: none">50% e AB janë të certifikuar	67% ³	<ul style="list-style-type: none">90% e AB të Certifikuar	83% (qershor 2017)
	<ul style="list-style-type: none">% e implementimit të rekomandimeve nga menaxhmenti.	<ul style="list-style-type: none">51% e implementimit të rekomandimeve nga menaxhmenti	53.98% ⁴	<ul style="list-style-type: none">Implementimi mbi 65% e rekomandimeve nga menaxhmenti	54.70% (vitin 2016)

Prioriteti 9: Fuqizimi i auditimit të jashtëm

Prioriteti nëntë i shtyllës së tretë adreson aktivitetet në fushën e auditimit të jashtëm dhe objektivi kryesor është zhvillimi i një institucioni suprem të auditimit që funksionon mirë, i cili kryen auditime në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik (IPSAS). Gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore është raportuar progres në zbatimin e të pesë (5) aktiviteteve gjithsej të planifikuara për arritjen e këtij prioriteti. Pas miratimit të Ligjit të ri, i cili ka përcaktuar qartë pavarësinë e institucionit Auditori i Përgjithshëm ka vazhduar me hartimin e legjislacionit sekondar. Me qëllim të vlerësimit të përputhshmërisë së auditimeve të kryera me ISSAI ka vazhduar bashkëpunimi me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë. Në të njëjtën kohë është raportuar për azhurnim të rregullt të udhëzuesit dhe metodologjisë së ZKA-së për auditimin e rregullsisë dhe performancës në përputhje me standardet

³ viti 2015

⁴ viti 2015

ndërkombëtare të auditimit. Po ashtu kanë vazhduar bashkëpunimet me dy komisionet parlamentare: Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe Komisioni për Buxhet për të diskutuar çështjet në lidhje me përmbledhjet e raporteve të auditimit të ZKA për Komisionet parlamentare, më konkretisht përgatitja e materialeve për trajtimet e Raporteve të auditimit. Në këtë fazë raportimi nuk mund të bëhet në nivel të indikatorëve për shkak të natyrës së indikatorëve të përcaktuar në nivel vjetor.

1.4 Shtylla 4.- Çështjet e ndërlidhura të MFP

Prioriteti 10: Përmirësimi i sistemeve të TI

Thesari gjatë kësaj periudhe gjashte mujore ka zhvilluar një mori aktivitete në funksion të përmirësimit të sistemit të teknologjisë informative dhe proceseve që ndërlidhen me procesin buxhetor. Aktualisht SIMFK është duke funksionuar në V7 (Revizioni 38998) duke ofruar qasje Online përmes Rrjetës Qeveritare për 2,094 përdorues nga të gjitha Organizatat Buxhetore. Në fillim të vitit është importuar Buxheti i vitit 2017 automatikisht nga sistemi i BDMS dhe alokimet janë bërë po ashtu përmes importimeve sipas planifikimit të rrjedhës së parasë të prezantuar nga OB-të. Gjatë kësaj periudhe SIMFK ka komunikuar/ndërlidhur në mënyre elektronike me këto sisteme të treta: Sistemi i Pagesave Ndër-bankare në BQK, BDMS, PIP, ZKA, ATK, Dogane, DOJQ, KEDS. Janë gjeneruar raporte elektronike me të gjitha sistemet e treta me të cilët Thesari ka marrëveshje për shkëmbimin e të dhënave. Fusha e raportimeve është mbështetur nga IT e Thesarit me Raporte kristale të gjeneruara sipas skripteve që realisht janë raporte specifike për kërkesat e raportimit në GFS/FMN dhe e-GDDS. Është përfunduar me sukses implementimi i platformës për qasje të OB-ve në SIMFK përmes platformës në WEB, dhe të gjitha OB-të janë informuar për ndryshimet përmes udhëzuesve të krijuara për qasje në shërbimet e Thesarit duke përdorur kompjuterët e Organizatave Buxhetore.

Ndërlidhja dhe zhvillimi i modulit të Sistemit Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK) me RTGS+ACH pranë BQK-së. Procesi ka filluar dhe janë mbajtur takime ndërmjet zyrtareve të Thesarit dhe të BQK-së, ndërsa jemi në finalizim të përgatitjeve të specifikacionit teknik i cili do të dërgohet kompanisë për zhvillimin e këtij moduli.

Krijimi i specifikacionit teknik për krijimin e Sistemit të ri për Menaxhimin e Parasë së Gatshme dhe Alokimeve, ndërsa presim përgjigje edhe nga kompania FreeBalance për mundësinë e ofrimit të këtij moduli.

Ndërsa planifikohet që në gjashtëmujorin e dytë 2017 të zhvillohen këto aktivitete në funksion të përmirësimit të sistemeve të TI-së.

- Pranimi i pajisjeve të reja të Thesarit me një kapacitet të dyfishuar të Serverëve të cilët janë konfiguruar nga ana harduerike dhe në proces do të jenë pjesë softuerike.
- Planifikohet testimi dhe Përditësimi në revizionin më të ri V7 (me numër Revizioni 62245) i cili aktualisht është në fazën e testimit dhe shumë funksione të cilat aktualisht janë të ngadalshme është vërejt një përmirësim në performancën, sidomos në pjesën e gjenerimit të raporteve, lëshimi të ekstrakteve të kuponëve të shpenzimit për pagese dhe procesit të importimit të kuponëve të shpenzimit.
- Planifikimi po bëhet edhe për Rishikimin elektronik të Buxhetit me rastin e aprovimit të tij në parlament.
- Planifikohet të fillohet me zhvillimin e një moduli i cili do të ndërlidhet në mënyrë të automatizuar me SNPK pranë BQK-se.

- Planifikimet po bëhen edhe në zhvillimin e një vegje për Planifikimin Elektronik të rrjedhës së parasë.
- Në këtë periudhë planifikohet konfigurimi i SIMFK-2018 i cili do varet nga vendimi që do bëhet në nivel të buxhetit 2 apo 5 shifror.

Prioriteti 11: Transparenca për buxhetin

Thesari në periudhën gjashtëmujore të vitit 2017 ka bërë publikimin e të dhënave mujore - seritë kohore për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për periudhën 2006 deri 2017. Në ueb-faqen e MF është mundësuar publikimi dhe qasja në të dhëna fiskale në baza mujore, në format elektronik, duke ofruar transparencë të plotë për shfrytëzimin e parasë publike. Thesari në baza mujore azhurnon seritë kohore për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore. Avancimi në raportim sipas Statistikave Financiare Qeveritare (GFS)–FMN-së, mbështetur nga AT e FMN dhe Projekti i USAID është harmonizuar me planin kontabël aktual me standardet e GFSM 2014. Ky standard raportimi është aplikuar në raportimin vjetor që Kosova ka bërë në GFS dhe tani në vazhdimësi është duke punuar që të publikoj të dhënat tremujore për Qeverinë e Përgjithshme që ndryshe quhet raportimi i frekuencave të larta. Janë azhurnuar meta data në e-GDDS për FMN në baza mujore, po ashtu janë rifreskuar të dhënat edhe për Borxhin publik tremujorësh (Q1, Q2, Q3 dhe Q4 për vitet 2015 dhe 2016)

Ndërsa planifikohet që në gjashtëmujorin e dytë 2017 të zhvillohen këto aktivitete në funksion të përmirësimit të transparencës.

- Azhurnimi dhe publikimi në Vjetarin e GFS sipas GFSM 2014 me të dhënat për periudhën 2011 – 2016 për Qeverinë e përgjithshme dhe për Borxhin publik 2014-2015 në FMN dhe BB,
- Publikimi i të dhënave në GFS për Qeverinë e përgjithshme për periudhën Q1 dhe Q2 për vitin 2017,
- Publikimi i serive kohore në baza mujore,
- Raportimi nëntëmujor të buxhetit 2017 sipas kërkesave ligjore,
- Avancimi i kualitetit të të dhënave në e-GDDS nga GFS86 në GFSM2014.

Informatori për qytetaret - për Buxhetin e Republikës së Kosovës 2017 është i publikuar në ueb-faqen e Ministrisë së Financave (në linkun <http://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,33>). Ndërsa, për vitin 2018 është formuar grupi punues brenda Departamentit të Buxhetit që është i obliguar ta hartoj draftin narrativ të buxhetit.

Prioriteti 12: Ngritja e qëndrueshme e kapaciteteve në MFP

Gjatë periudhës raportuese janë hartuar Termat e Referencës për Studimin e Fizibilitetit. Në bashkëpunim me Zyrën e BE është duke u përgatitur takimi i donatorëve relevant në fushën e MFP, për të parë mundësinë e përkrahjes me Asistencë teknike në zhvillimin e Studimit të fizibilitetit. Përfundimi i studimit të fizibilitetit është parakusht për zbatimin e dy aktiviteteve vijuese që kanë të bëjnë me hartimin e kurrikulës dhe ofrimin e trajnimeve.

ANEKSI 1: SHPJEGIM I DETAJUAR MBI ZBATIMIN E SECILIT AKTIVITET

1.1 *Shtylla 1.- Disiplina fiskale*

Prioriteti 1: Saktësia e parashikimit të indikatorëve makroekonomik dhe të hyrave;

Komente për statusin e aktiviteve 1.1- 1.5

Në arritjen e objektivit ‘Saktësia e parashikimit të indikatorëve makroekonomik dhe të hyrave’, janë paraparë 5 aktivitete që ndërlidhen me përforsimin e disiplinës fiskale si një parakusht, në mirëmbajtjen e qëndrueshmërisë fiskale. Aktivitetet përfshijnë fazat duke filluar nga trajnimi i stafit përgjegjës në parashikime dhe deri te publikimi i dokumenteve relevante të cilat përcaktojnë përgjegjësinë institucionale kundrejt publikut dhe partnerëve tjerë ndërkombëtarë. Në të gjitha aktivitetet e dhëna, vlerësimi kundrejt arritjeve në vitin 2016 tregon që ka një progres. Më saktësisht:

(1.1) Të siguruarit e kapacitetit të mjaftueshëm të stafit të trajnuar të njësisë makroekonomike. Gjatë periudhës Janar-Qershor 2017 kanë vazhduar trajnimet për stafin, si nevojë për trajnime përkatëse në fushën e makroekonomisë në veçanti modelimin e indikatorëve makroekonomik dhe projeksionin e të hyrave fiskale. Përveç trajnimeve tjera për këtë qëllim ka filluar trajnimi i të gjithë stafit nga “The government of the grand duchy of Luxemburg”. Faza e parë e trajnimeve është mbajtur në muajin Maj 2017. Trajnimet janë paraparë të jenë në disa faza, do të vazhdojnë gjatë vitit 2017 si dhe gjatë vitit 2018.

(1.2) Publikimi i metodologjisë së hartimit të parashikimeve ekonomike. Gjatë kësaj periudhe raportuese nuk është ndërmarrë ndonjë aktivitet në lidhje me publikimin e metodologjisë së hartimit të parashikimeve makroekonomike. Duhet marrë iniciativa për ngritjen e kualitetit të analizave të modelit me qëllim të ngritjes së saktësisë së parashikimeve ekonomike. Gjithashtu duhet të punohet në ngritjen e bashkëpunimit me Institucionet Ndërkombëtare Financiare rreth paralajmërimit të hershëm të ndryshimeve në ekonominë botërore që kanë ndikim në parashikimin e të hyrave.

(1.3) Publikimi i kornizës makro-fiskale dhe indikatorëve ekonomikë para miratimit të KASH dhe Ligjit Vjetor të Buxhetit. Edhe gjatë vitit 2017 korniza makro-fiskale dhe indikatorët ekonomik janë publikuar si pjesë të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve. Publikimi i kornizës makro-fiskale dhe indikatorëve ekonomikë para miratimit të KASH dhe Ligjit Vjetor të Buxhetit, mbetet aktivitet në drejtim të së cilit duhet të punohet gjatë periudhës së mbetur të vitit 2017.

(1.4) Vendosja e pavarësisë së njësisë makroekonomike. Nuk është ndërmarrë ndonjë aktivitet gjatë periudhës raportuese. Është aktivitet i cili është parashikuar të ndermirret gjatë vitit 2018.

(1.5) Nxjerrja e një rregulloreje që do ta kufizonte përfshirjen e të hyrave që ndodhin vetëm një herë. Nuk është evidentuar progres konkret. Ende nuk është themeluar Grupi punues për kufizim të përfshirjes së të hyrave të njëhershme në Ligjin Vjetor të Buxhetit.

Prioriteti 2: Kontrollat efektive të zotimeve

Komenti për statusin e arritjeve në aktivitetet 2.1-2.10

Për arritjen e këtij qëllimi, strategjia ka grupuar 9 aktivitete. Marrë parasysh kohën e shkurtër për të cilën po raportohet, ne kemi parë progres të pjesshëm në zbatim tek 3 aktivitete. Më saktësisht:

(2.1) Ndryshimet në LMFPP / Rregullore.- Nuk është evidentuar progres konkret. Veprimi ka të bëjë me ndryshimet ligjore në KBFP. Pas aprovimit në Qeveri të Ligjit të KBFP gjatë vitit 2016, janë hartuar draftet e akteve nënligjore dhe pritet aprovimi i Ligjit në Kuvend

(2.2) Trajnimi dhe ndërtimi i kapaciteteve të zyrtarit (-ëve) financiar.- Aktiviteti është zbatuar. Në bashkëpunim me Qeverinë e Luksemburgut më 11-14 prill janë trajnuar 100 zyrtarë financiar për menaxhimin e rrezikut. Ky trajnim do të mbahet edhe në periudhën K4-2017.

(2.3) Futja në përdorim e kontabilitetit të keshit të modifikuar dhe raportimit- Nuk ka aktivitete të parapara për këtë periudhë raportuese.

(2.4) Identifikimi dhe krijimi i kontroleve.- Ky aktivitet po vazhdon. Pilotimi po vazhdon sipas planit strategjik për 5 (pesë) pilot organizata buxhetore: Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Komuna e Lipjanit, Komuna e Podujevës dhe Komuna e Vushtrrisë. Pritet nënshkrimi nga Ministri i Financave i Librit të Përshkrimit të Proceseve të Menaxhimit të Shpenzimit të Parave. Janë përpunuar informatat e marra nga pyetësorët vet vlerësues dhe raportet e njëjësive të auditimit të brendshëm. Këto informata janë përdor për raportin vjetor për funksionimin e sistemit të KBFP në sektorin publik për vitin 2016. Është përgatit Raporti vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik për vitin 2016, dhe është dorëzuar për komente te Ministri.

(2.5) Zgjerimi i funksioneve të SIMFK.- Janë blerë serverët në TM3 dhe Thesari është duke punuar në funksion të përmirësimit të funksionimit të SIMFK

(2.6) Rishikimi i rregullores financiare për raportimin e vonesave në pagesa.- Nuk është evidentuar progres konkret. Nuk ka zhvillime në këtë aktivitet

(2.7) Raportimi i borxheve të brendshme nga Njësia e borxheve- Thesari konform Rregullës financiare për vonesat në pagesa bën konsolidimin e raporteve individuale të borxheve/vonesave në pagesa të raportuara nga OB-të.

(2.8) Sanksionimi i organizatave buxhetore në rastet e vonesës në pagesa- Nuk është evidentuar progres konkret. Deri me tani nuk është raportuar për progres në zbatim të këtij aktiviteti. Në TM3 do fillohet me monitorimin e OB-ve duke krahasuar dokumentacionin financiar dhe regjistrimet në SIMFK. Po ashtu do bëhet automatizimi I dërgimit të informatës/vërejtjes direkt nga SIMFK nëpërmes email-it tek Zyrtari Kryesor Administrativ, Zyrtari Kryesor Financiar dhe Zyrtari Përgjegjës për mos respektim të afateve ligjore për ekzekutim të pagesave.

(2.9) Monitorimin e OB-ve nëpërmes SIMFK-së dhe arkivës elektronike.- Është duke u punuar në krijimin e veglës së veçantë në kuadër të SIMFK ku për secilin proces, gjatë një

pagese të bëhet bashkëngjitja e dokumentit financiar ((skanimi dhe dokumentimi në SIMFK: kontrata, raporti I pranimit, fatura)

(2.10) Ngritja e kapaciteteve tek Njësia për Monitorimit (NJpM) - Nuk është evidentuar progres konkret. Nuk është raportuar për organizim të trajnimeve gjatë këtij gjashtëmujori.

Prioriteti 3: Mbledhja e qëndrueshme e të hyrave

Komenti për statusin e arritjeve në aktivitetet 3.1-3.12

Lidhur me realizimin e këtij prioriteti, ATK dhe Doganat e Kosovës duke u bazuar edhe në Planin e Veprimit për zbatimin e SRMFP, gjatë periudhës raportuese Janar-Qershor 2017 ka arrite rezultatet si në vijim:

(3.1) Themelimi i Agjencisë së Tatimeve dhe Doganave të Kosovës (ATDK)-

Janë krijuar grupet punuese për hartimin e UA të identifikuar. Gjatë periudhës raportuese është punuar në draftimin e dy Udhëzimeve Administrative, dhe atë në:

- UA për zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë, referuar nenit 7 të Projektligjit aktual, si dhe në
- UA për Kodin e Mirësjelljes dhe Procedurave disiplinore për zyrtarët e Agjencisë, referuar nenit 7, paragrafit 8.8 të Projektligjit aktual.

Finalizimi i tyre ndërlihet me procedimin e mëtejme dhe miratimin e Projektligjit për ATDK në Qeveri dhe Parlament.

Grupi Koordinues ka përgatitur një raport preliminar për Ministrin e Financave ku ka ofruar rekomandimet përkatëse për akomodimin e menaxhmentit të ri të ATDK-së.

(3.2) Futja e shërbimit elektronik të e-faturës- Nuk është raportuar progres. Në lidhje me këtë aktivitet nuk është shënuar progres gjatë periudhës për arsye të mos alokimit të kërkesës buxhetore për vitin 2017. Ky është projekt i bartur nga viti 2016, për të njëjtën arsye. Si hap korrigjues është planifikuar të përsëritet kërkesa duke përfshirë edhe ndryshimet e fundit në procedurën e rimbursimit të cilat këtë projekt e bëjnë të domosdoshëm për zbatimin e ndryshimeve të fundit ligjore.

(3.3) Modernizimi i sistemit të teknologjisë informative - Gjatë kësaj periudhe raportuese janë realizuar dy misione të asistencës teknike nga eksperti i angazhuar nga FMN. Nga dy ekspertizat janë prodhuar dokumente dhe udhëzues për përditësimin e kërkesave për shfrytëzues për sistemin e ri si dhe një raport vlerësues lidhur me kualitetin e të dhënave në sistemin informativ aktual në ATK. Gjithashtu është formuar grupi i cili do i finalizoj dhe zyrtarizoj dokumentet themelore për procesin e tenderimit.

Ky grup përbëhet nga ekspertë adekuat nga fusha e tatimeve dhe ajo e teknologjisë informative. Si rezultat i punës së grupeve teknike në bashkëpunim me ekspertin janë përfunduar, dokumenti me terma të referencës për kërkesat funksionale dhe teknike, dhe janë përgatitur kriteret para-kualifikuese për Operatoret Ekonomikë.

(3.4) Rritja e shkathtësive dhe aftësive të stafit / Ndërtimi i kapaciteteve të Sektorit për Menaxhimin e Rrezikut. Lidhur me ngritjen e kapaciteteve të stafit në fushën e menaxhimit të rrezikut të përbushjes, gjatë gjashtëmujorit të parë 2017, në programin e trajnimeve ndërkombëtare nuk është paraparë ndonjë trajnim nga kjo fushë. Prandaj si zgjidhje është arrite të sigurohet një asistencë teknike 2 javore nga FMN, ku eksperti ka qenë i fokusuar në

vlerësimin e modulit aktual të rrezikut dhe në modelin e identifikimit të rreziqeve. Gjithashtu nga raporti i dorëzuar kanë dalë disa rekomandime për të cilat duhet të vazhdohet me misionet nga FMN në gjashtë mujorin e dytë 2017. Të dy komponentët, softueri i biznes inteligjencës dhe moduli CAKI, janë të parapara në termat e referencës për sistemin e ri të TI.

(3.5 -3.6) Në fushën e trajnimeve janë mbajtur 6 aktivitete trajnuese rreth teknikave të zbulimit të kontrabandës, me gjithsej 13 zyrtarë të trajnuar si dhe gjithashtu janë mbajtur 8 aktivitete trajnuese në fushat e vlerësimit, tarifimit dhe origjinës së mallrave me gjithsej 60 zyrtarë të trajnuar.

(3.7) Rifreskimi rregullt i profileve të riskut, për të adresuar rreziqet e mallrave të nënvlerësuar. Gjatë periudhës Janar – Qershor 2017, në sistemin e selektimit në ASYCUDA janë aktivizuar 72 kritere të riskut, ndërsa janë azhurnuar 1989 subjekte në lista të ndryshme selektivitetit. Azhurnimet e profileve bëhen në varësi të riskut të paraqitur dhe si rrjedhojë krijohen kritere të reja për të goditur riskun.

(3.8) Aplikimi i patrullave në vijën kufitare me fokus në vendet e njohura me risk të lartë. Dogana e Kosovës në vazhdimësi aplikon patrullime në vendet e njohura me risk të lartë. Këto patrullime zhvillohen kryesisht nga ekipet e antikontrabandës dhe gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar një numër I konsideruar I tyre prej 1866 patrullime. Gjithashtu me qëllim të identifikimit të mallrave, mjeteve dhe personave të cilët janë të përfshirë në kontrabandim. Doganë i shfrytëzon edhe kamerat mobile të cilat I vendos në varësi të riskut të identifikuar. Me përdorimin e këtyre kamerave janë shënuar edhe rezultate konkrete në identifikimin e automjeteve që përdoren për kontrabandim si dhe ndalimin dhe konfiskimin e mallrave të kontrabanduara.

(3.9) Aktivizimi i sistemit të kamerave (Donacion nga EXBIS) të kontrollit të kufirit në vijën e gjelbër. Kamerat e vëzhgimit statik janë aktive dhe ato përdoren në varësi nga rastet apo edhe trendet e kontrabandimit. Me përdorimin e këtyre kamerave janë shënuar edhe rezultate konkrete në identifikimin e automjeteve që përdoren për kontrabandim si dhe ndalimin dhe konfiskimin e mallrave të kontrabanduara.

(3.10) Aplikimi i kontrolleve të përbashkëta me Policinë Kufitare. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i aktiviteteve kufitare me Policinë e Kosovës gjatë gjashtë mujorit të parë është zhvilluar ashtu siç është planifikuar. Janë zhvilluar patrullime dhe takime, të rregullta. Janë organizuar 39 takime të përbashkëta (K1 19 dhe K2 20) dhe 17 patrullime për ngritje të nivelit të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve ku si rrjedhojë janë kryer edhe patrullime të përbashkëta në drejtoritë rajonale me Policinë Kufitare. Gjatë periudhës raportuese numri i operacioneve të përbashkëta me Policinë e Kosovës është gjithsej 11 operacione (K1 5 dhe K2 6 operacione).

(3.11) Rritja e informatave nga sektori i Inteligjencës për drejtoritë rajonale. Gjatë periudhës janar-qershor 2017. Sektori i Inteligjencës në sektorët dhe drejtoritë rajonale në Doganë ka shpërndarë 190 informacione të përpunuara.

(3.12) Aplikimi i duhur i metodave të vlerësimit të mallit. Dogana e Kosovës për vlerësimin e mallrave i përdor gjashtë metodat e Organizatës Botërore të Tregtisë. Gjatë gjashtëmujorit të parë 2017, janë përdorur të gjashtë metodat e vlerësimit. Përqindja më pastaj varion nga dokumentacioni i prezantuar për të dëshmuar vlerën reale të mallit në fazën e zhdoganimit.

Shtylla 2.- Efikasiteti alokues

Prioriteti 4: Zhvillimi i kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH)

Komente për statusin e arritjeve ne aktivitetet 4.1.-4.5

Për arritjen e këtij objektivi janë planifikuar pese aktivitete dhe në këtë periudhë të raportimit gjashtëmujorë janë zhvilluar këto aktivitete:

(4.1) Funkcionalizimi i Grupit Drejtues për Planifikim Strategjik (GDPS), dhe i Komisionit për Planifikim Strategjik. Sa i përket këtij aktiviteti Grupi Drejtues për Planifikim Strategjik (GDPS) dhe i Komisionit për Planifikim Strategjik kanë shqyrtuar Deklaratën e Prioriteteve dhe po ashtu Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (2018-2020), ndërsa sa i përket aktivitetit te 3.-të që ka të bëjë me shqyrtimin e Draft Buxhetit vjetor pritet të realizohet ne Tetor 2017, kur edhe bëhet dorëzimi i buxhetit për vitin 2018 nga MF ne Qeveri

(4.2) Trajnimi për fuqizimin e vlerësimit të ndikimit buxhetor. Për këtë aktivitet MF ka ofruar këshillime profesionale të duhura dhe të nevojshme për zyrtarë të OB-ve të nivelit qendrorë, dhe për këtë periudhë të raportimit ky aktivitet është në vazhdimësi. 50 zyrtar të OB të këshilluar, sugjeruar sqarime në lidhje me plotësimin e formularëve për VNB.

(4.3) Përgatitja e njoftimeve sqaruese për shmangie ndërmjet kufirit të KASH dhe kufirit të buxhetit vjetor. Ndërsa sa i përket aktivitetit për përfshirjen e Tabelës së standardizuar për paraqitjen e shmangieve në kufijtë e KASH dhe ndarjes buxhetore finale, ky aktivitet është ne proces dhe pritet qe me rastin e dorëzimit te Projekt Ligjit te Buxhetit ne Kuvend për vitin 2018 te i bashkëngjiten edhe këto tabela.

(4.4) Vlerësimi i rrezikut nga organizatat buxhetore për planifikim të buxhetit. Në bashkëpunim me Qeverinë e Luksemburgut më 11-14 prill janë trajnuar 100 zyrtarë financiar për menaxhimin e rrezikut. Ky trajnim do të mbahet edhe në periudhën K4-2017.

(4.5) Zbatimi i qasjes sektoriale gjatë përgatitjes së KASH. KASH 2017-2019 është përgatitur sipas qasjes sektoriale (12 Sektorë). Aktivitet i kryer, KASH 2018-2020 është punuar në baza sektoriale

Prioriteti 5: Besueshmëria dhe kontrolli i ekzekutimit të buxhetit vjetor

Komente për statusin e arritjeve ne aktivitetet 5.1-5.3

(5.1) Përgatitja e udhëzimit administrativ për transferimet – ri-alokimet – Është formuar grupi punues brenda Departamentit të Buxhetit që është i obliguar ta hartoj draftin e këtij UA

(5.2) Buxhetimi i bazuar në programe. Ky aktivitet është parapare pas vitit 2018, nuk ka ndonjë veprim konkret, me rishikimin e PV te strategjisë 2018-2020 do te shikohet hapat qe do te ndërmerren për këto aktivitete.

(5.3) Hartimi i një plani strategjik për buxhetimin Programor. Ky aktivitet është parapare pas vitit 2018, nuk ka ndonjë veprim konkret, me rishikimin e PV te strategjisë 2018-2020 do te shikohet hapat qe do te ndërmerren për këto aktivitete.

Prioriteti 6: Cilësia e informatave të buxhetit kapital

Komenti për statusin e arritjeve në aktivitetet 6.1.-6.4

(6.1) Miratimi i një Rregulloreje/ Instruksioni nga Qeveria për ta fuqizuar Departamentin e Buxhetit që ofron një kornizë të qartë për politik-bërësit dhe përdoruesit e PIP-it në lidhje me metodologjinë e vlerësimit dhe përzgjedhjen e projekteve- Është formuar grupi punues brenda Departamentit të Buxhetit që është i obliguar ta hartoj draftin e kësaj Rregulloreje. Deri ne fund te vitit pritet qe te hartohet kjo rregullore dhe te përcillet tutje për aprovim

(6.2) Organizimi i trajnimit për sistemin PIP (trajnimi i zyrtarëve të rinj si dhe rifreskimi i njohurive të zyrtarëve ekzistues)- Deri ne muajin Maj 2017 janë trajnuar gjithsej 40 zyrtar për sistemin e PIP-it

(6.3) Nxjerrja e një udhëzimi që e definojnë qartë se çka duhet të trajtohet projekt kapital - Është formuar grupi punues brenda Departamentit të Buxhetit që është i obliguar ta hartoj draftin e këtij **UA**

(6.4.) Punësimi i 3 Zyrtarëve të TI për mirëmbajtje dhe zhvillim të sistemit. Aktiviteti i përfunduar në vitin 2016.

Shtylla 3.- Efikasiteti operacional

Prioriteti 7: Prokurimi Publik

Komente për statusin e arritjeve ne aktivitete 7.1-7.5

(7.1) Themelimi i sistemit të e-prokurimit për krverjen e aktiviteve të prokurimit. Në mbështetje të vendimit të Qeverisë të vitit 2016, nga 1 janari I vitit 2017 te gjitha autoritetet kontraktuese kane filluar përdorimin e sistemit te e-prokurimit.

(7.2) Zhvillimi dhe zbatimi i aktiviteve të centralizuara të prokurimit.-

Qeveria e Kosovës ka obliguar AQP-në që nga data: 01.04.2017 të zhvilloj të gjitha prokurimet me E-prokurim. Pasi që Platforma nuk ka qenë e gatshme dhe Operatorët ekonomik nuk kanë qenë të trajnuar, si rrjedhojë Qeveria e Kosovës ka plotësuar vendimin e lartcekur duke vendosur që të mbetet në diskrecionin e operatorëve ekonomik ofertimi në formë fizike apo elektronike deri në një vendim tjetër të KRPP-së (vendimi i Qeverisë së Kosovës nr. prot:18/140 të datës 05.04.2017).

Agjencioni Qendror i Prokurimit (AQP) për çdo vit kalendarik i dorëzon në Qeveri përkatësisht në Ministrinë e Financave dhe në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik një raport vjetor që analizon aktivitetet e prokurimit publik të udhëhequra nga AQP-ja për atë vit kalendarik. AQP bazuar në raportin e KRPP-së të vitit 2016 në lidhje me kontratat e nënshkruara vetëm me buxhetin e konsoliduar të Kosovës (BKK), dhe vetëm për dy Lloje të prokurimit (shërbime

dhe furnizime) të cilat janë me udhëzime administrative ka arritur që të nënshkruaj kontrata si në vijim :

Vlera e kontratave të nënshkuara sipas llojit të prokurimit (€) viti 2016			
	AK-BKK	AQP	% e GDP
Furnizim	190,926,041.02	37,145,753.13	
Shërbime	58,915,351.43	4788354.91	
Totali	249,841,392.45	41,934,111.04	16.8 %

Bazuar në këto statistika AQP ka marrë pjesë me 16.8 % në buxhet të konsoliduar të Kosovës (BKK). Ky trend presim të sillet në parametra të ngjashëm edhe gjatë vitit 2017.

(7.3) Monitorimi i aktiviteteve të prokurimit publik - Departamenti për monitorim dhe mbikëqyrje i KRPP-se gjatë periudhës së parë gjashtë mujore të vitit 2017, ka realizuar monitorimin e tridhjetë e nëntë (39) aktivitete të prokurimit , sipas rastit – kërkesës, së Autoriteteve Kontraktuese-së, Operatorëve Ekonomik apo palëve të interesuara, Si dhe ka bere monitorimin e rreth 80% të njoftimeve për publikim ne ueb faqen e KRPP-se.

(7.4) Vetëdijesimi i publikut të gjerë lidhur me rregullat e prokurimit publik- Nuk është evidentuar progres konkret. Pritja për këtë veprim nuk është përmbushur pjesërisht. Në kuadër të këtij aktiviteti, KRPP së bashku me OSHP-në dhe AQP-në, mbajtën konferencë në Prishtinë më 08.02.2017, me qëllim të vetëdijesimit për të arriturat në avancimin e Prokurimit Publik në 2016 dhe Sfidat aktuale dhe Mundësitë e Prokurimit Publik në Kosovë, (Diskutim në tryezën e rrumbullakët gjithashtu). Të ftuar në këtë konferencë kanë qenë Institucionet vendore dhe ndërkombëtare, Organizatat e Shoqërisë Civile, Biznese, etj. Gjithashtu, KRPP me 30.06.2017, ka mbajt edhe Konferencën përmbyllëse të projektit “Përmirësimi i Kapaciteteve Administrative në Fushën e Prokurimit Publik në Kosovë” që ka filluar me 10 dhjetor të viti 2012 dhe i cili financohet nga BE, ku ka prezantuar përmirësimet e vazhdueshme në proceset e Prokurimit Publik në aspektin legjislativ dhe praktik, që kanë rezultuar në zhvillime të rëndësishme dhe përfitime për tatim paguesin në Kosovë.

(7.5) Trajnimi i zyrtarëve të prokurimit- Arritja e përcaktuar nga ky veprim është përmbushur.

KRPP në bashkëpunim me IKAP ka mbajt trajnimin Intensiv-të përshpejtuar për tri institucionet kryesore te prokurimit ne Kosove, KRPP-në. OSHP-në dhe AQP-në dhe ka bërë certifikimin e tyre. Trajnimi ka filluar me datën 14.02.2017 dhe ka përfunduar më 10.03.2017. Trajnimi ka qenë 15 ditor(intensiv, çdo dite) dhe ka përfshirë 10 module te trajnimit Themelor profesional për Prokurimi Publik.

Prioriteti 8. Fuqizimi i Auditimit të Brendshëm

Komentet për statusin e aktiviteteve 8.1 – 8.5

Për arritjen e objektivit “Fuqizimi i auditimit të brendshëm” janë planifikuar 5 aktivitete që ndërlihen me fuqizimin e auditimit të brendshëm si parakusht për shtimin e vlerës ndaj menaxhimit llogaridhënës.

Në të gjitha aktivitetet e dhëna, vlerësimi kundrejt arritjeve tregon që ka progres, si:

(8.1) Rishikimi i Ligjit për funksionimin e Auditimit të brendshëm. Ky aktivitet ka vonesë krahasuar me Planin. Sidoqoftë është përgatitë Ligji për KBFP dhe draft aktet nënligjore. Ligji për KBFP është në proces të aprovimit nga Kuvendi i Kosovës. Pas aprovimit të Ligjit për KBFP nga Kuvendi i Kosovës do të aprovohen aktet nënligjore dhe do të organizohet trajnimi për zyrtarët përgjegjës.

(8.2) Freskimi i manualit të Auditimit të Brendshëm. Ky aktivitet është planifikuar të ndërmerret gjatë vitit 2018.

(8.3) Ngritja e programit vendor për Certifikimin e Auditorëve të Brendshëm dhe trajnimi sipas nevojës. Gjatë periudhës raportuese është organizuar trajnimi për certifikimin e auditorëve të brendshëm në programin për certifikim për grupin e dytë. Në këtë trajnim janë përfshirë 39 pjesëmarrës. Prej 157 auditorëve të brendshëm 130 janë të certifikuar (ose 83%). Prej tyre 60 me certifikata vendore dhe 70 me certifikata nga CIPFA që janë të punësuar si auditor të brendshëm në sektorin publik. Përveç trajnimit për certifikim të auditorëve të brendshëm janë organizuar edhe trajnime tjera që mbështesin funksionin e auditimit të brendshëm. Trajnimet e organizuara gjatë periudhës raportuese janë: Trajnimi për përgatitjen e raporteve, trajnimi për fuqizimin e ekipeve të auditimit të brendshëm dhe trajnimi për auditimin e teknologjisë informative.

(8.4) Trajnimi i auditorëve të brendshëm në auditimin e fondeve të BE. Nuk është evidentuar progres konkret. Për shkak të mungesës buxhetore nuk është ndërmarrë ende ndonjë aktivitet. Për realizimin e këtij aktiviteti duhet marrë iniciativë për përgatitjen e kërkesës në Komisionin Evropian apo ndonjë donatori tjetër që mund ta përkrah këtë aktivitet.

(8.5) Monitorimi i implementimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm. Bazuar në raportin vjetor për KBFP për vitin 2016 shkalla e implementimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm është si në vijim; 54.70% janë implementuar, 25.69 % në proces të implementimit dhe 19.61 % nuk janë implementuar.

Prioriteti 9: Fuqizimi i auditimit të jashtëm

Komenti për statusin e arritjeve në aktivitetet 9.1-9.4

(9.1) Sigurimi i pavarësisë institucionale. Me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri nr. 05/L-055 “Për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës”, të dekretuar më 03/06/2016, është rregulluar qartë pavarësia funksionale, operative dhe financiare, mandati i Auditorit të Përgjithshëm si dhe organizimi i ZKA.

(9.2) Trajtimi i zbrazëtirës ndërmjet praktikës së auditimit të ZKA-së dhe të ISSAI-ve (SNISA). Me qëllim të vlerësimit të përputhshmërisë së auditimeve të kryera me ISSAI ka vazhduar bashkëpunimi me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë. Për këtë qëllim ZKA ka ftuar ZKA të Suedisë që të bëjë një vlerësim të ZKA sipas Kornizës së Matjes së Performancës së Institucionit Suprem të Auditimit. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2017, ZKA të Suedisë ka bërë një vlerësim të lehtë të ZKA sipas asaj Kornize.

Për këtë aktivitet në periudhën e ardhshme do të adresohen çështjet e identifikuara në Raportin e Vlerësimit bazuar në Kornizën e Matjes së Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit të kryer nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë.

(9.3) Përditësimi i Udhëzuesit për Auditimin e Rregullsisë. Udhëzuesi i ri i auditimit të rregullsisë në pajtim me ISSAI-të - Udhëzuesi dhe metodologjia e ZKA-së për auditimin e rregullsisë azhurnohen në vijimësi për të qenë në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit. Ngritja e kapaciteteve dhe zhvillimi profesional i stafit të auditimit është një nga objektivat strategjike të ZKA. Gjatë periudhës janar –qershor 2017, janë organizuar trajnime brenda vendit nga trajner të brendshëm dhe ndërkombëtar. U zhvilluan trajnime në 8 tema trajnimi për 106 auditor dhe trajnime jashtë vendit në 10 trajnime për 13 pjesëmarrës.

Për këtë aktivitet në periudhën e ardhshme:

- a) Do të plotësohet udhëzuesi i rregullsisë me pjesën për auditime të ndërmarrjeve publike.
Me ndihmën e projektit të binjakëzimit të financuar nga Bashkimi Evropian do të ngritën kapacitetet të stafit të auditimit për auditimet e ndërmarrjeve publike që përdorin bazën aktuale të kontabilitetit;
- b) ZKA me përkrahjen e ekspertëve të jashtëm (Bankës Botërore, Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë, etj.) do të hartojë edhe udhëzuesin për auditime të pajtueshmërisë. Për më tepër, do të organizohen edhe programe trajnimi për implementimin e manualit për auditime të pajtueshmërisë dhe pilot projekte nën mentorimin e ekspertëve të jashtëm;
- c) Në sesionin gusht-shator do të vazhdohet me trajnime të brendshme për të thelluar njohuritë për auditime të rregullsisë.

(9.4) Zhvillimi i mëtejshëm i praktikës së auditimit të performancës. Udhëzuesi dhe metodologjia e ZKA për auditime të performancës azhurnohet në vijimësi për të qenë në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit. Nëpërmjet bashkëpunimit me ZKA të Suedisë ka vazhduar mentorimi i auditimeve të performancës dhe janë mbajtur punëtori me tema që kanë të bëjnë me auditime të Performancës.

Për këtë aktivitet, në periudhën e ardhshme, në lidhje me trajnimin dhe certifikimin e auditorëve të Performancës, pritet të dizajnohet dhe implementohet skema e certifikimit me përkrahjen e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë dhe partnerëve tjerë.

(9.5) Përfshirja e Kuvendit

Për nën aktivitetin “Zhvillimi i punëtorive të përbashkëta për të zhvilluar më tutje marrëdhëniet” – me përkrahjen e GIZ-it është mbajtur punëtori me dy komisionet parlamentare: Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe Komisioni për Buxhet për të diskutuar në lidhje me përmbledhjet e raporteve të auditimit të ZKA për Komisionet parlamentare, më konkretisht përgatitja e materialeve për trajtimet e Raporteve të auditimit.

Ndërsa sa i përket nën aktivitetit “Organizimi i konferencës 2 ditore me 200 pjesëmarrës” – Më 13 korrik 2017, është mbajtur Konferenca e 9 Vjetore e ZKA, ku termë diskutimi ishte “Fuqizimi i llogaridhënies, transparencës dhe integritetit të institucioneve të sektorit publik, përmes zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm”, ku të ftuar kanë qenë edhe përfaqësues të institucioneve publike dhe Kuvendit.

Për këtë aktivitet në periudhën e ardhshme:

- a) Do të diskutohen mundësitë me Institucionet Supreme të Auditimit partnere për organizimin e vizitave studimore të përbashkëta me komisionet parlamentare përkatëse;
- b) Do të vazhdohet komunikimi me komisionet përkatëse parlamentare me qëllim të koordinimit më të mirë për trajtimin e Raporteve të Auditimit;
- c) Përmes komunikimit të vazhdueshëm dhe përkrahjes së komisioneve parlamentare ZKA synon të rris numrin e trajtimeve të Raporteve të auditimit në Kuvend dhe rritjen

e shkallës së rekomandimeve të adresuara përkatësisht zvogëlimin e shkallës së rekomandimeve të pa adresuara.

Shtylla 4.- Çështjet e ndërlidhura të MFP

Prioriteti 10: Përmirësimi i sistemeve të TI

Komenti për statusin e arritjeve në aktivitetet 10.1-10.3

(10.1) Integrimi i sistemeve të TI në MF dhe agjencitë e saja vartëse- Nuk është evidentuar progres konkret. Kanë përfunduar specifikimet vitin e ardhshëm do të behet publikimi I tenderit për integrimin e sistemeve te TI-së

(10.2) Modernizimi i SIMFK, ngritja e kapaciteteve te teknologjisë informative të Thesarit.- Nuk është evidentuar progres konkret. Janë blerë serverët në TM3 dhe Thesari është duke punuar në funksion të përmirësimit të funksionimit të SIMFK

(10.3) Krijimi i një arkivi elektronik për Organizatat Buxhetore.
Nuk është evidentuar progres konkret. Nuk është raportuar aktivitet.

Prioriteti 11: Transparenca për buxhetin

Komenti për statusin e arritjeve në aktivitetet 11.1-11.6

(11.1) Modifikimi i SIMFK për ta mundur përgatitjen e automatizuar të raporteve të buxhetit në pajtim me GFS.- Është në proces përgatitja e dokumentit ku specifikon të gjitha kategoritë ekonomike në planin kontabël dhe jep detaje të mjaftueshme në formë përshkrimi se çka regjistrohet në secilin kod të planit kontabël. Planifikohet që në TM4 të zhvillohet një trajnim lidhur me përmirësimin e regjistrave kontabël dhe raportimin.

(11.2) Rishikimi i planit kontabël të Qeverisë- Nuk është evidentuar progres konkret. Gjatë TM4 planifikohet formimi i grupit punues për Rishikim të Rregullës për planin kontabël ku do mundësoj zbatimin në procesin e planifikimit gjatë vitit 2018.

(11.3) Miratimi i një strukture të re kontabël të harmonizuar me IPSAS dhe GFS dhe të inkorporohet në SIMFK. Ekipi që po punon ne Planin Kontabël dhe IT e Thesarit janë duke bashkëpunuar ngushtë në funksion të dizajnit të Skripteve ku do gjenerohen raporte specifike konform kategorizimit të GFSM 2014.

(11.4) Përkthimi i Manualit për statistikat financiare qeveritare dhe trajnimi i zyrtareve për strukturën e re kontabël. Në TM4 2017 planifikohet një punëtori së bashku me Zyrtarët Kryesor Financiar e OB-ve për të përmirësuar procesin e zbatimit të planit kontabël dhe kategorizimin adekuat të shpenzimeve.

(11.5) Publikimi i serive kohore të të hyrave dhe shpenzimeve të qeverisë së përgjithshme
- Në baza mujore po raportohen dhe publikohen seritë kohore.

(11.6) Hartimi i Dokumentit të Buxhetit Miqësor (Narrativ).- Informatori për qytetaret - për Buxhetin e Republikës së Kosovës 2017 është i publikuar në ueb-faqen e Ministrisë së Financave (në linkun <http://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,33>). Ndërsa, për vitin 2018 është formuar grupi punues brenda Departamentit të Buxhetit që është i obliguar ta hartoj draftin narrativ të buxhetit.

Prioriteti 12. Ngritja e qëndrueshme e kapaciteteve në MFP

Komenti për statusin e arritjeve në aktivitetet 12.1-12.3

(12.1) Zhvillimi i studimit të fizibilitetit mbi Qendrën e Trajnimeve për MFP, përfshirë vlerësimin e nevojave për trajnime.- Janë hartuar Termat e Referencës për Studimin e Fizibilitetit. Ne bashkëpunim me ZBE është duke u përgatitur takimi I donatoreve relevant ne fushën e MFP, për te parë mundësinë e përkrahjes me Asistence teknike ne zhvillimin e Studimit te fizibilitetit.

12.2 Përgatitja e Kurrikulës në Menaxhimin e Financave Publike.

Nuk është raportuar progres, pasi fillimisht duhet përfunduar Studimi i fisibilitetit.

12.3 Ofrimi i trajnimeve në fushën e MFP

Nuk është raportuar progres, pasi fillimisht duhet përfunduar Studimi i fisibilitetit dhe përgatitja e kurrikulës.